



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2023:166645

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05426174

P.nr216/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Shefqet Baleci, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Elheme Kastrati, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.G nga ..., Lagja ..., rruga “...” nr...., Komuna e Drenasit, për vepër penale Kanosja, të parashikuar nga neni 181 par.2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.4502/2023, datë.28.07.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.07.03.2024, ku ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm Eset Rama, dhe i akuzuari, e në mungesën e të dëmtuarit A.G, me dt.**07.03.2024** mori dhe publikisht shpalli, si dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: L.G, i biri i ... dhe i ..., mbiemri i saj i vajzërisë ..., i lindur me dt..... në ..., Komuna e Drenasit, ku edhe tani e ka vendbanimin Lagja ..., rruga “...” nr...., me numër personal të letërnjoftimit ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i dy fëmijve të miturë, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike, i gjendjes së rëndë shëndetësore,më parëipagjykuar, nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE: me datë 01.07.2023, rreth orës16:30 minuta, në fshatin ..., Komuna e Drenasit, i akuzuari me qëllim të frikësimit, kishte kanosur seriozisht me fjalë se do të privoj nga jeta të dëmtuarin vëllaun e tij A.G, në atë mënyrë që, deri të mosmarrëveshja fillimisht verbale në mes tyre, kishte ardhur si pasojë, që i akuzuari me të dëmtuarin kishin probleme pronësore, ku i akuzuari nga oborri i shtëpisë së tij, të dëmtuarit i ishte drejtuar me fjalët “të kam paralajmëruar disa herë që të mos të hysh në oborrin tim se të mbys, largohu prej pronës se të mbys tërfurk”, me të cilat veprime të dëmtuarit A.G, i kishte shkaktuar ankth, frikë dhe pasiguri për jetë,-

- me këtë ka kryer vepër penale Kanosja, të parashikuar nga neni 181 par.2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Andaj gjykata në vështrim të neneve 4,7,17,21,38,69,81,82 dhe nenit 181 par.2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe nenit 359,360,364,452 par.4. dhe 462 par.2. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

Ku të akuzuarit i bëhet me dije se ka kryer një veprë të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën veprë penale dhe nëse kryen prapë veprë të tillë, gjykata do të i shqiptoi sanksion më të rëndë penale.

I akuzuari për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike lirohet nga pagimi i paushallit gjyqësor si dhe nga pagimi i taksës për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

I dëmtuari A.G nga ..., Lagja ..., rruga "...", Komuna e Drenasit, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar me këtë veprë penale, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Pergjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.4502/2023, datë.28.07.2023, ka akuzuar të akuzuarin për veprë penale Kanosja, të parashikuar nga neni 181 par.2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me dt.07.03.2024, ku ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm Eset Rama dhe i akuzuari. Nuk ishte i pranishëm i dëmtuari A.G

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari e ka udhëzuar të akuzuarin për të drejtat e tij, ashtu siç e parashehë neni 319 par.1. dhe par.2. të KPP-së. I akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar udhëzimet për të drejtat e tij.

Shqyrtimi gjyqësor ka filluar me leximin e aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.4502/2023, datë.28.07.2023, nga Prokurori i Shtetit Eset Rama, duke përjashtuar pjesët e aktakuzës të specifikuar në par.3. të nenit 237 të KPP-së, ashtu siç e parashehë neni 320 të KPP-së.

Në bazë të nenit 321 par.1. të KPP-së, pasi që gjyqtari është bindur se i akuzuari e kuptonë aktakuzën, të akuzuarit ia ka dhënë mundësinë që të pranojë ose të mos e pranojë fajësinë.

Në bazë të nenit 321 par.1. të KPP-së, i akuzuari ka deklaruar se e pranon fajësinë në tërësi, për të gjitha pikat e aktakuzës dhe gjyqtari në bazë të nenit 242 par.2. të KPP-së, ka përcaktuar se: 1.- i akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; -2.- pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i akuzuari dhe pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, përveç premtimeve të cekura në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë sipas nenit 230 të këtij Kodi; -3.- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, siç janë dëshmitë e dëshmitarëve-të dëmtuarve; dhe 4.- aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Në bazë të nenit 322 par. 2. të KPP-së, në shqyrtimin e pranimin të fajësisë së të akuzuarit, gjyqtari ka dëgjuar mendimin e prokurorit të shtetit.

I njëjti deklaroi se janë përmbushur kushtet nga neni 242 par.2. të KPP-së.

Në bazë të nenit 322 par.4. të KPP-së, gjyqtari ka vlerësuar se kërkesat nga neni 242 par.2. të KPP-së janë përmbushur, dhe shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i Shtetit i Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm Eset Rama, në fjalën përfundimtar, deklaroi: meqenëse i akuzuari e ka pranuar fajësinë, pranimi i fajësisë është bërë në bazë të nenit 242 par.2. të KPP-së dhe është në përputhshmëri me provat në të cilat është mbështetur aktakuza. Me këtë është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar në dispozitivin e aktakuzës dhe se i njëjti është kryes i veprës penale me të cilën ngarkohet. I propozojmë gjykatës që të njejtin të e shpall fajtor dhe të e dënoi sipas ligjit. Me rastin e marrjës së vendimit mbi dënimin, si rrethanë lehtësuese të marr pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

I akuzuari L.G, deklaroi: e kam pranuar fajësinë, gjykatës i premtoi se në të ardhmën nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të tjera penale, pendohem për veprën e kryer penale, kërkoi falje, e pranoi se kam gabuar, shprehi keqardhje, deklaroi se jam i sëmurë, veshkën e majtë e kam të hequr, jam në terapi të vazhdueshme, gjendjen ekonomike e kam tejet të dobtë, pa të ardhura, jetoi nga ndihmat solidare që më ofrojnë të tjerët, kërkoi nga gjykata që të më shqiptoi një dënim sa më të butë.

Duke i vlerësuar me ndërgjegje provat e nxjerra në procedurë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, në bazë të nenit 7 par.1. dhe nenit 360 të KPP-së, gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjendjen e këtyre faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe nga provat dhe faktet që i përmban aktakuza.

Nisur nga këto fakte dhe prova të vërtetuara në procedurë, në veprimet e të akuzuarit, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale të lartëtheksuar, të cilën e ka kryer me dashje direkte, me çka e ka dëshiruar kryerjen e kësaj vepre penale.

I akuzuari e ka kryer këtë vepër penale, sepse në bazë të nenit 7 të KPRK-së, kjo vepër penale është vepër e kundërligjshme, e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është përcaktuar sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm.

Për këtë vepër penale është shpallur fajtor, sepse në përputhje me nenin 17 par.1 të KPRK-së thuhet se "kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia". Në rastin konkret i akuzuari këtë vepër penale e ka kryer me dashje direkte sipas nenit 21 par.2. të KPRK-së, ku është paraparë sanksioni penal.

Gjatë përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata për të akuzuarin, pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin merr faktin se e ka pranuar fajësinë, gjykatës i premtoi se në të ardhmën nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të tjera penale, pendohet për veprën e kryer penale, kërkoi falje, shpreh keqardhje, e pranoi që ka gabuar, i martuar, mbajtës i familjës, kryefamiljarë, baba i dy fëmijëve të miturë, të moshës 17 dhe 15 vjeçare, i papunë, i gjendjes së dobtë ekonomike dhe i gjendjes së rëndë shëndetësore, e ka të hequr veshkën e majtë, është në terapi të vazhdueshme, ndërsa rrethana rënduese gjeti se kemi shkallë të lartë të dashjes nga ana e të akuzuarit gjatë kryerjes së veprës penale (e paraprë me nenin 70 par.1. dhe par.2. nënpar.2.2. të KPRK-së). Andaj edhe pse për veprën penale Kanosje, të parashikuar nga neni 181 par.2. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), është i paraparë dënimi me gjobë ose me burg deri në 1 (një) vit, të njëjtit i shqiptoi vërejtje gjyqësore, sepse duke patur parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me veprën dhe kryesin, vërejtja gjyqësore është e mjaftueshme për të arritur qëllimin e dënimit duke u bazuar në nenin 81 të KPRK-së. Dhe në bazë të nenit 82 par.1. lidhur me par.3. të KPRK-së, të akuzuarit i bëhet me dije se ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën vepër penale dhe nëse kryen prapë vepër të tillë, gjykata do të i shqiptoi sanksion më të rëndë penal, me bindjen se shqiptimi i vërejtjes gjyqësore është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmerisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësin penale të akuzuarit, dhe se i njëjti do të ndikoi që të parandaloi të akuzuarin nga kryerja e veprave penale

në të ardhmën dhe të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e të dëmtuarit për dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

I akuzuari në bazë të nenit 4523 par.4. të KPP-së, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike lirohet nga pagimi i paushallit gjyqësor si dhe nga pagimi i taksës për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, pasi që pagesa do të rrezikonte gjendjen materiale të tij si dhe të personave që ai detyrohet të i mbështesë materialisht.

Vendimin që i dëmtuari A.G nga ..., Lagja ..., rruga "...", Komuna e Drenasit, lidhur me realizimin e kërkesës pasuroro juridike për kompenzimin e dëmit të shkaktuar me këtë veprë penale, të e udhëzoi në kontest civil, gjykata e bazoi në nenin 462 par.2. të KPP-së, pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë të kësaj kërkesë.

Nga e lartëtheksuara është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.216/20231, datë:07.03.2024

Procesmbajtësja
Elheme Kastrati

G j y q t a r i
Shefqet Baleci

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, personat e autorizuar (të paraparë sipas nenit 381 par.1. të KPP-së), kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë (e paraparë sipas nenit 374 par.1. nënpar.1.1. të KPP-së), në afat prej tredhjetë (30) ditëve (e paraparë sipas nenit 380 par.1. të KPP-së), duke llogaritur nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.

Ankesa e personit të autorizuar e paraqitur brenda afatit të caktuar si më lartë, e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit (e paraparë në bazë të nenit 380 par.3. të KPP-së).